



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 958/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nehat Idrizi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për ankesën e subjektit politik Savez Kosovskih Srba (SKS) dega në Graçanic, paraqitur kundër Građanska Inicjativa Srpska (G.I Srpska), për shkak të fillimit të fushatës zgjedhore para kohës së caktuar për Zgjedhjeve Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 26.11.2013, mori këtë:

## V E N D I M

**HIDHET** poshtë si e palejuar ankesa e subjektit politik Savez Kosovskih Srba (SKS) dega ne Graçanic.

## A r s y e t i m

Në ankesën e parashtruar ne PZAP, me datë 25.11.2013, nga subjekti politik SKS, dega në Graçanic, pretendohet se ne objektin e institucionit publik në “Shtëpinë e Shëndetit” në Graçanic, është vendosur pllakat me porosi parazgjedhore të subjektit politik Građanska Incjativa Srpska G.I Srpska gjë e cila është në kundërshtim me Rregullat Zgjedhore dhe ndikon direkt tek të punësuarit në “Shtëpinë e Shëndetit në Graçanic” .

Në mbështetje të pretendimeve ankimore parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi.

PZAP-i, duke vendosur sipas ankesës gjeti se:

- ankesa është e palejuar

PZAP-i, duke u bazuar ne dispozitat e nenit 33 te LZP-së, me të cilin ndalohen veprimet e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore ashtu siç parashihen në pikat a) b) c) d) të këtij neni, po ashtu me nenin 44 të LZP-së, 44.1 pikat a) b) c) ju përcaktohen te drejtat subjekteve politike për veprimet e tyre gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. Meqenëse pretendimet ankimore të parashtruesit te ankesës janë zhvilluar para datës së caktuar për fillimin e fushatës zgjedhore, për Raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale që do të mbahen me dt.01.12.2013, siç përcaktohet me dispozitat e lartcekura ligjore, nuk mund të sanksionohet pretendimet e parashtruesit te ankesës ngase veprimet e Gradanska Inicijativa Srpska në "Shtëpinë e Shëndeti" ne Graçanic duke i vendosur njoftim me porosi para zgjedhore kanë ndodhur me datë 21.11.2013 para fillimit te fushatës zgjedhore, këto veprime nuk sanksionohen me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe as me Rregullat Zgjedhore që PZAP-i të ndërmerr masa ligjore para fillimit të fushatës zgjedhore, andaj në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**

Anr. 958/2013 më datën 26.11.2013.



***Këshill juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*